

**UNITED NATIONS**  
United Nations Interim  
Administration Mission  
in Kosovo



**NATIONS UNIES**  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations Unies au  
Kosovo

**PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT**

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**TRANSKRIPT**

**NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS**  
**E MBAJTUR MË 14 MARS 2007**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA**  
**ODRŽANE 14. MARTA 2007. GODINE**

---

**Mars – Mart**  
**2007**

## **RENDI I DITËS**

- 1. Njoftim mbi rrjedhën e bisedimeve përfundimtare të mbajtura me datën 10 mars 2007 në Vjenë  
( Raporton Grupi i Unitetit)**

## **DNEVNI RED**

- 1. Obaveštenje o toku završnih pregovora održanih dana 10. marta 2007. godine u Beču  
( Izveštava Grupa uniteta ).**

KRYESUESI SABRI HAMITI – Ju lutem do ta fillojmë seancën e sotme. Në sallë kemi 94 deputetë. E kemi një pikë të rendit të ditës të cilën e keni marrë më herët - Njoftimi mbi rrjedhën e bisedimeve përfundimtare të mbajtura më 10 mars 2007 në Vjenë.

Kemi me ne sot edhe një pjesë, jo të tërën, të Grupit Negociator të Kosovës, dy prej tyre janë në udhëtim zyrtar jashtë Kosovës.

Pra, zotëri President i Kosovës Fatmir Sejdiu, zotëri Kryeministër i Kosovës Agim Çeku, zotëri anëtar i Grupit Negociator, Hashim Thaçi, zotërinj ministra të Qeverisë së Kosovës, kolegë deputetë të çmuar e të nderuar.

Për fillim të kësaj seance fjalën e merr kryetari i Kosovës, Fatmir Sejdiu, i cili është njëkohësisht edhe udhëheqës i Grupit Negociator.

PRESIDENTI I KOSOVËS FATMIR SEJDIU – I nderuari kryesues i seancës z. Hamiti, i nderuari Kryeministër dhe ministra të Qeverisë së Kosovës, të nderuar deputetë.

Siç jeni njoftuar të shtunën e kaluar më 10 mars 2007 përfunduan bisedimet në Vjenë lidhur me çështjet e veçanta që kanë të bëjnë edhe me statusin e Kosovës, nën udhëheqjen e presidentit Ahtisari.

Ky ishte takimi i fundit në nivelin më të lartë përfaqësues të vendeve. Ishte ky një proces i gjatë dhe i vështirë që zgjati rreth 14 muaj. Delegacioni i Kosovës e ka informuar këtë Kuvend në vazhdimësi lidhur me bisedimet duke pasur mbështetjen e tij të njëkohshme. Po kështu, para konsultimeve shtesë që u mbajtën para tatimit të fundit në Vjenë, në këtë Kuvend u zhvillua një debat i gjerë dhe i rëndësishëm lidhur me propozimin gjithëpërfshirës të presidentit Ahtisari, ose, siç jemi mësuar ta quajmë Pakon e Ahtisarit.

Delegacioni i Kosovës përmes delegacioneve të tij, si më parë ashtu edhe së fundi në konsultimet shtesë që zhvilluan nga fundi i shkurtit dhe ditët e para të marsit 2007, ka shtruar edhe një herë qëndrimet e tij lidhur me këtë propozim, që si të tilla janë ndërtuar duke pasur parasysh, pos tjerash edhe vërejtjet dhe shqetësimet e paraqitura në Kuvend dhe të njëjtën kohë edhe nga institucionet e tjera dhe qytetarët. Duke pasur parasysh faktin se Pakoja e presidentit të Ahtisarit e përmbyllur tani në strukturën e saj të tërësishme, krahas elementeve të tjera që i trajton për pozitën e komuniteteve pakicë në Kosovë, ajo si e tillë përmban bazë themelore dhe të qëndrueshme për shtetin e pavarur dhe sovran të Kosovës, si dhe duke pasur parasysh edhe mbështetjen e Kuvendit të Kosovës, ne i kemi pranuar në parim si të tillë.

Serbët dhe pakicat e tjera në Kosovë në këtë pako të statusit të Kosovës marrin të drejta dhe garanca që sigurojnë përfaqësimin e tyre politik, ose them më saktë dhe mbi përfaqësimin politik, por edhe të drejta vetëqeverisjeje në rrafshin lokal që pakicat e tjera në këtë pjesë të Evropës mund t'ua kenë lakmi.